



Republika e Kosovës

Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komiteti për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

Nr. 18	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	15.09.2023 në ora 14:00
Mbledhjen e kryesoi:	Enver Rugova, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut
Procesmbajtës:	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Hajrush Shoshi, Faruk Kabashi, Liridona Lajçi, Ardita Idrizaj, Ajshe Metaj dhe Niman Beqiraj.
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjerë:	Kryetari i Komunës, z. Ilir Ferati, Nënkryetari i Komunës Ali Nimanaj. Drejtorët: Merita Muzliaj Bytyçi, Genc Ademaj, Agon Dreshaj, Dukagjin Hoxhaj, Zenel Shatri, Naim Behlulaj, Abedin Kabashi, Arben Kabashi, zyrtar administrativ: Ardon Arifaj.
Rendi i ditës: 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara, 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2024 - 2026, 3. Shpallja në diskutim Publik e Draft - Statutit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën Istogut	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit -përshëndeti të pranishmit. Konstaton të gjithë anëtarët e KPF-së janë prezent, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e mbledhjes. Hapi punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për ditën e sotme. Prezanton rendin e ditës, Fton ekzekutivin si dhe anëtarët e KPF-së nëse dikush ka ndonjë pyetje sugjerim apo ndonjë propozim për rend dite?	
Kryesuesi i Kuvendit a ka edhe dikush diçka. Pasi që nuk ka dikush diçka,	

Hedh në miratim rendin e ditës:	
Kush është që të miratohet rendi i ditës.	
Miratohet rendi i ditës për mbledhjes e sotme unanim.	
Prezent në mbledhje janë të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa.	
Vendimet:	
Miratohet me shumicë votash rendi i ditës, me këtë propozim nga Ekzekutivi.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 1.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit - Enver Rugova, vazhdojmë më procesverbal, Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara. A ka dikush diçka rreth procesverbaleve?	
Pasi që nuk ka diskutime.	
Hedh në votim, kush është që të miratohen procesverbalet nga mbledhjet e kaluara?	
Miratohen unanim procesverbalet nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.	
Vendimet:	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 2.	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit- vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2024 – 2026,	
Kryetari i Komunës, z. Ilir Ferati - përshëndet të gjithë të pranishmit, bën sqarimin e Draft Buxhetit për vitin 2024 – 2026, dhe për sqarim te detajuar ia kalon fjale, ZKF –së z. Osmon Sadikaj.	
Zyrtari Kryesor Financiar, z. Osman Sadikaj - ërshëndet të gjithë të pranishmit, bëne prezantimin dhe sqarimin e Draft Buxhetit për vitin 2024 – 2026.	
Kryesuesi i Kuvendit – hap debatin fjalën ja kalon :	
Hajrush Shoshi - përshëndet të gjithë të pranishmit, pyet sa është numri i punonjësve në arsim?	
Niman Beqiraj - përshëndet të gjithë të pranishmit, dua një sqarim tek sporti dhe rekreacioni për ndërtimin e sallës së sportit në Vrellë janë nda 150 mijë euro kjo e di që me kontratë kanë qen në Arsim, dua ta bej një pyetje se a është shkëputur kontrata apo e keni ber ndonjë ndërrim të menaxhmentit apo si se nuk e kam shumë të qartë edhe të mënyra e financimit në buxhet që ke dëgjimi publik që është me pare të komunës këtu po shkruan që është grand qeveritar burimi i financimit.	

Drejtori për Buxhet e Financa, z. Genc Ademaj - stafi në Arsim në qarkoren 2 ne na kanë ardhur 5 vende me pak në arsimin fillor e që ne jemi të obliguar me e respektuar uljen e numrit të stafit në atë pjesë mendoj që kjo ka ndodhur krejt në bazë të planifikimit të të dhënave që i kanë zyrtaret në ministrin e Arsimit.

Buxheti përbehet nga grandi qeveritar dhe të hyrat, që janë buxhete tonat që ne mund ti orientojmë, Sqaron të gjitha pyetjet e bëra.

Ajshe Metaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, u fol për fshatin serdarin edhe pse drejtori tha që është punuar në Saradran. Propozoj që në fshatin Saradran të realizohet kanalizimi se të gjitha projektet janë të rëndësishme por kanalizimi pos ujësjellësit është i rendit të dytë krahasuar me ujin, unë mendoj që një pjesë e disa projekteve që kanë prioritet pak ma pak dhe presin propozoj që të adresohet çështja e kanalizimit në fshatin Saradran. Unë nuk po mund të them se cili projekt është me pak apo me shumë i rëndësishëm aty po e kam një kërkesë kështu me plot mendje se në fshatin Saradran ka nevojë për e ndonjë kanalizim se janë projekte të mëdhaja dhe nuk mund të fillohen me një fazë se një shumë e ndonjë projekti që ndoshta pret e ato mjete të vendosen në kanalizimin në fshatin Saradran.

Farku Kabashi - përshëndet të gjithë të pranishmit, dy projekte në Gurakoc: Asfaltimi i rrugës "Smajl Kabashi" ka përfunduar kjo rrugë 2022, edhe ndërtimi i rrugës në Lagjen "Gegaj" dhe Kabashi këto në lagjen Kabashi a kanë pas me u asfaltuar sivjet.

Drejtori për Buxhet e Financa, z. Genc Ademaj - Sqaron të gjitha pyetjet e bëra.

Kryetari i Komunës, Ilir Ferati - Sqaron të gjitha pyetjet e bëra.

Ardita Idrizaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, kam një propozim në fshatin Lubozhd rruga "Ledinat" e kam propozuara edhe me herët por nuk e pash në buxhet të planifikuar askund.

Kryetari i Komunës, Ilir Ferati - në këtë rrugë është e planifikuar faza e par kanalizimi pastaj të shtrohet asfalti kemi qen në teren, profesorësh ne e dimë që është prioritet dhe vitin e ardhshëm i ndajmë 50 mijë euro dhe fillojmë si prioritet kanalizimin.

Liridona Lajqi Avdijaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, Rruga në Sine.

Kryesuesi i Kuvendit - pasi që diskutime tjera nuk ka ,
Nga anëtarët e KPF-së miratohet unanim që ti kaloj Kuvendit të Komunës për shqyrtim.
Shtatë anëtarë prezent në mbledhje.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF - ja unanim ia kalon kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim Draft Buxhetit për vitin 2024 - 2026.

Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
--	-------------------------------

Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
--------------------------	------------------------------

Shqyrtimi i pikës 3.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit - po vazhdojmë më pikën e tret të rendit të ditës, Shpallja në diskutim Publik e Draft – Statutit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Istogut.

A dëshiron dikush të diskutoj, pasi që diskutime nuk ka

Hedh në miratim:

Miratohet unanimit nga anëtarët e KPF-së.

Të gjithë anëtarë prezent në sall.

Vendimet:

Pasi që vërejtje dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF –ja unanimit, ia kalon Kuvendit të Komunës për Shpallja në diskutim Publik e Draft – Statutit të Qendrës për Punë Sociale në Komunën e Istogut.

Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit

Kryesuesi i kuvendit, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj : 15: 00

Procesmbajtëse,
Znj. Vjosa Hysenaj



Kryesuesi i Kuvendit,
z.Enver Rugova

